



Funded by
the European Union

TERMAT E REFERENCËS

Emri i projektit	“Ngritja e mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, si reagim ndaj ndikimit të COVID-19”- Projekt i implementuar nga HANDIKOS në partneritet me Save the Children.
Lloji i angazhimit	Edukator/e joformal/e
Lokacioni	Prishtinë
Orari i punës	Orar të plotë (40 orë në javë)
Kohëzgjatja	Korrik – Dhjetor 2021 (Me mundësi vazhdimi)
Data e pritshme e fillimit	19 Korrik, 2021
Raporton tek	Menaxheri/ja i/e projektit

1. HYRJE

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (tani e tutje HANDIKOS), është organizatë jo-qeveritare e themeluar në vitin 1983, duke synuar arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në shoqëri. HANDIKOS mbron në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror të drejtat e PAK, duke synuar krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës përmes rritjes së mundësive të punësimit; përmirësimin e qasjes në edukim, mirëqenie sociale dhe skemave të mbrojtjes sociale; dhe përmirësimin e qasjes fizike.

1.1 Konteksti i programit

HANDIKOS në partneritet me Save the Children është duke implementuar projektin “Ngritja e mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, si reagim ndaj ndikimit të COVID-19”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian. Përmes këtij projekti HANDIKOS synon të mbështesë zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe lehtësimin e pasojave të COVID-19 në mirëqenien e tyre dhe familjes përmes shërbimeve multidisciplinare të qëndrimit ditor dhe bashkëveprimit ndërsektorial.

Në kuadër të këtij projekti, me qëllim të avancimit të zhvillimit edukativ, si përgjigje ndaj ndikimit të COVID-19 në edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fuqizimit të bashkëpunimit ndërsektorial, HANDIKOS është në kërkim të punësimit të një **Edukatori/e joformal/e**, me orar të plotë të punës.



Funded by
the European Union

2. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME E POZITËS

Edukatori/ja joformal/e do të jetë përgjegjës për ofrimin e shërbimit të edukimit joformal për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë vlerësimin e nevojave të fëmijëve, hartimin e planeve të punës sipas qasje multi-diciplinare; realizimin e seacave individuale dhe hartimin e raporteve të punës që dëshmojnë progresin e arritur të fëmijëve. Ai/ajo do të jetë urëlidhëse ndërmjet ofruesve të shërbimeve sociale, edukative dhe prindërve, në mënyrë që të koordinoj ofrimin dhe marrjen e shërbimeve. Edukatori/e joformal/e do të jetë përgjegjës edhe për ngritjen e njohurive dhe shkathtësive të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara rreth mbështetjes së zhvillimit edukativ të fëmijëve të tyre.

2.1 Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofrimi i shërbimit të edukimit joformal përmes seacave individuale;
- Identifikimi i përfituesve potencial të shërbimit dhe vlerësimi i nevojave edukative të tyre;
- Përpilimi i planeve individuale sipas parimeve të qasjes multi-diciplinare;
- Hartimi i raporteve mujore të progresit dhe dorëzimi i tyre me kohë;
- Funkcionon si urë-lidhëse ndërmjet HANDIKOS, ofruesve të tjerë të shërbimeve edukative dhe sociale, si dhe prindërve të fëmijëve përfitues të projektit;
- Bashkëpunon me institucionet relevante për të siguruar arritjen e objektivave të planeve individuale dhe identifikimin/referimin e fëmijëve;
- Realizon sesione informuese me prindërit e fëmijëve përfitues rreth mbështetjes së zhvillimit edukativ të fëmijëve të tyre;
- Hartimi i planeve javore dhe mujore të punës; dhe dorëzimi i tyre me kohë.

2.2 Njohuritë dhe përvoja:

- Diplomë universitare në fushën e edukimit ose shkencave sociale;
- Përvojë paraprake pune në pozita të ngjashme (përparësi kanë kandidatët me përvojë në fushën e aftësisë së kufizuar);
- Aftësi të mira në hartimin e planeve dhe raporteve të punës;
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe organizimit;
- Qasje gjithëpërfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar;
- Shkathtësi të mira ndër-personale dhe punës ekipore;
- Të jetë i familjarizuar me qasjen multi-diciplinare;
- Të ketë njohuri mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, dhe Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Qasje pozitive në zgjidhjen e problemeve;
- Aftësi për të punuar nën presion të kohës dhe për t'i respektuar afatet kohore;

3 DOKUMENTET PËR APLIKIM:

- Curriculum Vitae (CV);
- Letër e motivimit që argumenton përshtatshmërinë e kandidatit me pozitën e hapur;
- Të paktën një referencë nga punëdhënësi/bashkëpunëtorët e mëparshëm;
- Kopjen e diplomës së nivelit më të lartë të edukimit;
- Çertifikatën që dëshmon se kandidati nuk është nën hetime (në rast të përzgjedhjes).



Funded by
the European Union

**Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë dokumentacionin përkatës në e-mail:
handikos@handi-kos.org**

Me titull “Aplikim: Edukator/e joformal/e”

Afati i fundit për dorëzim të aplikacionit: 12 Korrik, 2021, deri në ora 23:59.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.

HANDIKOS është i përkushtuar për barazi gjinore dhe diversitet, dhe të ketë një ekip që përbëhet nga shkathtësi, përvoja dhe aftësi të ndryshme. Ne e inkurajojmë aplikimin e kandidatëve me prejardhje të ndryshme, dhe nga komunitetet dhe sektorët e ndryshëm.

